




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa**  
**Z/znj \_\_\_\_\_**

**Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.**

**F T O J**

**Mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 24.05.2022 ( e martë) duke filluar në ora 10:00.**

**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Shqyrtimi i draft statutit i Qendrës kryesore të mjekësisë familjare;
3. Aprovimi i rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;
4. Shqyrtimi i mundësive për fillimin e procedurave për planin në mbrojtje të vlerave natyrore në Komunën e Novobërdës;
5. Vazhdimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës dhe Hidromoraves;
6. Raportim dhe diskutim rreth gjendjes në ambulantat e Komunës;
7. Aprovimi i Rregullores për ndarje të subvencioneve;
8. Anulimi i vendimit nr.01/1337 dt.31.03.2022;
9. Me propozim të kryetarit të komunës, shqyrtimi i vazhimit të kontratës për shfrytëzim të objektit në pronësi të objektit komunal për nevojat e Ëestern Union Bank në bazë të Vendimit të Kuvendit nga Protokolli nr. 02- 177, datë 16.03.2016;
10. Me kërkesë të Kryetarit të Komunës, të shqyrtohet ndryshimi i nenit 69 të Statutit të Komunës ;
11. Të ndryshme.

**Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.**

**Më:18.05.2022**  
**Në: Novobërdë**

**Kryesuese e Kuvendit**  
**Mirjana Simijonovic**





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo**

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

Nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 20.04.2022, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović, Anëtarët e KPF-së: Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanović, Abdyl Gashi, Dragana Dimic, Drejtori i Financave z.Milosh Denic, Zyrtari i Sherbimeve Publike Bajram Abazi,

Kryesuesja pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së, konstaton se ka kuorum për punë dhe filloj mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raporti tremujor financiar Janar – Mars 2022;
3. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2021;
4. Pruarja e vendimit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkpunimit në mes të Komunës dhe Hidromoraves;
5. Anulimi i vendimit i aprovuar me 27.12.2018 me nr.protokoli 01-7 të datës 10.01.2019, "Kryetari i Komunës të mos ndaj subvencione pa vendim të Kuvendit";
6. Informim nga komisioni për emërimin e rrugëve;
7. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës së KPF-së.

**Pika e parë:** Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar nga anëtarët prezent të KPF-së.

**Pika e dytë:** Raporti tremujor financiar Janar – Mars 2022;

Për këtë pikë kryesuesja ja dha fjalën Drejtorit të Financave Milos Denic.

Milos Denic pasi përshëndeti të pranishmit tha: besoj se materialin e keni marrë me kohë, po filloj nga të hyrat i kemi 64,284.14€, por ta cekim se këto mjete nuk janë të regjistruara në sistemin e free balancit për arsye të problemeve teknike prandaj nuk janë të ndara këto mjete në kode ekonomike. Sa i perket mjeteve të shpenzuara, i kemi shpenzuar në këto kategori: për paga dhe medita 517,827.49€, për mallra dhe shërbime 25,487.59€, për shpenzime komunale 9,250€, për subvencione 128,376.63€, në raportin e mëtutjeshëm i keni të shpenzuara mjetet se ku janë shpenzuar në cilat Drejtori, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkojë në Kuvend.



**Pika e tretë:** Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2021;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Milos Denic.

Milos Denic tha: sa i perket kësaj pike kërkoj falje që materialin nuk e kam derguar me kohë, i kemi pasur disa probleme teknike, çka mundë të ju them rreth kësaj se këto mjete janë të hyra vetanake në shumë mbi 219,000€, dhe këto mjete do ti shperndajm, në investime kapitale, subvencione, mallra dhe shërbime dhe komunal.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e katërt:** Pruarja e vendimit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkpunimit në mes të Komunës dhe Hidromoraves;

Kryesuesja tha: këtu bëhet fjalë për një memorandum të bashkpunimit në mes të Komunës dhe Hidromoraves, duke pasur parasysh se Hidromorava i mbykqyr dhe kontrollon këto ujësjellëse dhe i furnizon qytetarët tonë me ujë të pishem, ndërsa për informata të mëtutjeshme ja kaloj fjalën zyratrit për shërbime publike Bajrsam Abazit.

Bajram Abazi pasi pershendeti të pranishmit tha: ne jau kemi derguar një draft marrëveshje më herët, kjo marrëveshje nënshkruhet çdo 4 vite me Hidromoraven, kjo marrëveshje është në nivel të Kosovës me të gjitha Komunitatet e Kosovës ndërsa sot na ka ardhur një marrëveshje tjetër që e kanë aprovuar në departament dhe që është aprovuar në asociacionin e Komunave të Kosovës, ne nuk patëm kohë me marrë me perktë dhe me shku me marrë në Gjilan, por do ta keni për mbledhje të Kuvendit. Kjo marrëveshje ka të bëjë me manxhimin e ujësjellsave dhe kanalizimeve për këto fshatra që janë në menaxhim të Hidromoraves pasi që ka edhe fshatra tjerë që nuk janë të kyçtur, andaj ju lus që ta aprovoni në mënyrë që të shkoj në Kuvend.

Kryesuesja tha: sa i perket Hidromoraves e di që i mbykqyr ujësjellsat por për kanalizim a keni pasur më herët marrëveshje?.

Bajram Abazi tha: po.

Kryesuesja tha: e di që sa herë që kanë pasur qytetarët problem me kanalizim e di se kanë bërë kërkesë në Komunë, komuna ka intervenuar në hidromoravë, hidromorava e ka zgjidhur problemin por në faktur që e marrëmi për ujë nuk ceket aty se sa kushton mirëmbajtja e kanalizimit.

Bajram Abazi tha: Komuna e paguan.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: besoj që do ta kemi me kohë marrëveshjen e re që ka ardhur, do të kemi mundësi në seancën e Kuvendit ta shqyrtojmë dhe analizojmë, gjithmonë kam qenë idhëtar i asaj që të përfshihet një marrëveshje që të funksionalizohet edhe ujësjellësi në fshatin Llabjan, besoj se me një seriozitet më të madhë edhe nga ndërrimi i pushtetit pasi që më herët nuk është marrë asnjë veprim.

Bajram Abazi tha: kanë ndodhur ato probleme më herët, lënda ende është në gjykatë, ne si D.SH.P kemi vetëm një procesverbal që është mbajtur atë ditë seanca, kur kemi filluar të bashkpunojmë me Hidromoraven që ti marrim në menaxhim në 2015 e kemi bërë një vlerësim të të gjithë ujësjellsave në Komunën e Novobërdës, përafqësues nga Komuna kam qenë unë dhe Nebojsa Arsic ish drejtor dhe për secilin ujësjellës janë këtu veç e veç. Ne kemi biseduar edhe me Abdylin dhe të tjerë deputetë, në mënyrë që ta bëjmë zgjedhjen e këtij problemi, Abdyl çdo herë ka qenë bashkpunues dhe kemi biseduar edhe me Drejtorin e SHP dhe besoj se shumë shpejt do të shkojmë në gjykatë që të shohim se deri ku ka arritur procedura.

Kryesuesja tha: këtë qështje që e ngriti Abdyl ndoshta deri në Kuvend do ta keni këtë përgjigje, është problem shumë i madhë kur bëhet fjalë për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijës.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e pestë:** Anulimi i vendimit i aprovuar me 27.12.2018 me nr.protokoli 01-7 të datës 10.01.2019, "Kryetari i Komunës të mos ndaj subvencione pa vendim të Kuvendit";

Kryesuesja tha: bëhet fjalë pra për anulimin e vendimit që e kemi pruar në mandatin e kaluar që Kryetari mos të ketë të drejtë në ndarje të subvencioneve pa vendim të Kuvendit, e kemi parasysh se si e kemi pasur situatën në mandatin e kaluar, këtë vendim atëherë e kemi pruar që të kemi një mënyrë më transparente më të hapur për ndarjen e këtyre subvencioneve apo ndihmave për arsye të



mosbashkpunimit, ndërsa tani ekzekutivi dhe legjislativi ka një bashkpunim shumë të mirë, do të duhej ta biem një vendim në Kuvend që ta anulojm atë vendim.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e gjashtë:** Informim nga komisioni për emërimin e rrugëve;

Kryesuesja tha: nuk e di a është prezent ndonjë antër i komisionit që të na informoj se a kanë filluar të punojn diçka.

Pranvera Kastrati Gashi tha: deri më tani nuk kemi asnjë informat, nuk na kan thirrur në asnjë takim, vetem kërkoj që komisioni i kaluar të na dorozj raportin se deri ku kan punuar.

Kryesuesja tha: në mandatin e kaluar kam qenë pjesë e atij komisioni dhe 10% e punës ka qenë e përfunduar e dini se dy vite na ka bllokuar pandemia dhe ne skemi pasur mundësi të dalim ne terren ti ftojm qytetarët në tubime, i kemi pasur edhe disa probleme në disa lagje apo rrugë, sikur mos ta kishim pas këtë problemin e virusit kjo punë kishte qenë e përfunduar. Pasi nuk ka pasur asnjë takim dhe ska asnjë informat nga komisioni kërkoj që kjo pikë të shtyhet në një nga mbledhjet e ardhshme.

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të shtyhet për një nga mbledhjet e radhes.

**Pika e shtatë:** të ndryshme;


Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: besoj dhe shpresoj që të na vij materiali me kohë e jo një ditë para mbledhjes.

Kryesuesja tha: e keni marrë një email se kur do të mbahet KPF-ja, ne e-mail kemi kërkuar falje, problemi ka qenë se jemi të lidht me rrjetin qendror, ne kemi pasur problem pasi që nuk ka funksionuar rrjeti, as qytetarëve nuk kemi pasur mundësi që tju kryejm pagesa dhe ky ka qenë problem, e dëgjut edhe Bajramin para gjysë ore i ka ardhur dokumenti dhe nuk ka pasur mundësi as me shtyp dhe duhet të mirëkuptohemi, ne po mundohemi që ti minimizojm këto probleme në mënyrë që në Kuvend ta keni materialin me kohë. Besoni se jemi shumë serioz dhe administrata e Kuvendit po punon jashtzakonisht në mënyrë serioze, mundë të ju them edhe atë po i lavdëroj pasi që administrata e Kuvendit ka një bashkpunim të jashtzakonshem me të gjitha Drejtoritë, gjatë gjithë kohës është në kontakt me të gjitha Drejtoritë, gjatë gjithë kohës kemi takime dhe mundohemi që çdo punë ta kryejm ashtu siç është më së miri, shumë shpejt do ta krijojm një rutin në mënyrë që të shkoj puna shumë më mirë.

Pasi përfundimit të diskutimit Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

Procesmbajtëse  
Valmire Mustafa  


Kryesuesja Kuvendit  
Mirjana Simijonović  
